



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS**  
**Hyrje në Gjuhësi**

**Ngarkesa:** 4 kredite (= 40 orë); 2 Kredite Leksion (= 20 orë); 2 Kredite seminar (= 20 orë)  
**Viti / Semestri :** Viti I , semestri II  
**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme  
**Programi i studimit:** Bachelor, Gjuhë Angleze  
**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

*Objektivat e përgjithshme lëndore:* Të pajisë studentët me njohuri bazë teorike dhe metodologjike mbi gjuhësinë si shkencë. Të prezantojë fushat kryesore të gjuhësisë: fonetikë, fonologji, morfologji, sintaksë, semantikë, pragmatikë etj. Të ndërtojë një kuptim ndërdisiplinor mbi natyrën dhe funksionin e gjuhës në kontekste biologjike, psikologjike, kulturore dhe sociale.

*Objektivat specifike lëndore:*

1. Të njohin studentët me konceptet dhe termat bazë të fushave gjuhësore dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.
2. Të njohin karakteristikat dhe funksionet e gjuhës së folur dhe të shkruar, si dhe avantazhet dhe disavantazhet përkatëse.
3. Të ndërgjegjësohen për shumëllojshmërinë e sistemeve gjuhësore dhe për ngjashmëritë strukturore midis tyre.
4. Të kuptojnë mënyrën sesi funksionon formimi dhe interpretimi i kuptimit në gjuhë.

*Rezultatet e pritshme:*

1. Studentët do të jenë në gjendje të analizojnë dhe interpretojnë struktura gjuhësore në nivel fjale, fjalie dhe teksti.
2. Do të kuptojnë mekanizmat përmes të cilëve gjuha përçon kuptim dhe se si mund të ndodhë dykuptimësia në strukturat gjuhësore.
3. Do të zbatojnë në praktikë njohuritë mbi familjet gjuhësore, ndryshimet historike dhe socio-kulturore të gjuhës.
4. Do të zotërojnë bazat e analizës gjuhësore që do t'u shërbejnë si themel për studimet e mëtejshme në gjuhësi, përkthim apo mësimdhënie.